

MËSIMET MË TË MËDHA BOTËRORE

QËLLIMET GLOBALE

“Ne e kemi vetëm një planet. Nuk kemi planet tjetër. Nëse i shfrytëzojmë si duhet aftësitë tona kreative, atëherë nuk kemi nevojë për ndonjë vend tjetër. Nëse kujdesemi për planetin dhe për njëri tjetrin, gjithçka që na nevojitet e kemi në duart tona”

Sër Ken Robinson

Autor/Pedagog

Lënda

Edukim Qytetar, Gjeografi, Shoqëri

Rezultatet e mësimit

Nxënësit mund të shpjegojnë se çka janë Qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, pse janë të rëndësishëm dhe si ndërlidhen me vetë nxënësit

Përgatitja

- Nëse është e mundshme shtypni dhe ekspozoni përpara klasës një kopje të Qëllimeve globale (shtojca 2 ose 3)
- Shtypni listën e Qëllimeve globale për referencën tuaj, si dhe shtypni materiale për secilin nxënës (shtojca 2 ose 3)
- Informacione dhe resurse për Qëllimet globale mund t'i merrni në www.globalgoals.org/worldslargestlesson
- Duhet të përcaktoni gjashtë stacione (pika) për informim të nxënësve tuaj. Një listë e Qëllimeve globale është e dhënë më poshtë me grupime të sugjeruara për të gjashtë stacionet (Shtojca 4). Shpërndani informacione në secilin stacion, ku do të mund të përfshini studime të shkurtra të rastit, tregime personale, fotografi, grafikë etj. Ju mund të gjeni resurse të përshtatshme në www.globalgoals.org/worldslargestlesson
- Këta stacione do t'iu mundësojnë nxënësve të mësojnë më shumë në lidhje me qëllimet
- Për një përshkrim më miqësor të Qëllimeve globale për fëmijët mund t'i referoheni dhe të zbritni materiale nga www.globalgoals.org/worldslargestlesson

Koha në dispozicion

30 minuta

Mosha

8-14 vjeç

Prezantimi i Qëllimeve Globale për Zhvillim të Qëndrueshëm

Aktiviteti mësimor

5 minuta

Kur të hynë nxënësit në klasë shpaloseni këto pyetje – “[Cilat janë problemet më të mëdha, me të cilat sot përballen njerëzit anekënd botës?](#)”

Nxënësit mund të kenë nevojë për inkurajim shtesë për të menduar nga këndvështrimi i të tjerëve dhe për ta parë fotografinë më të madhe.

Ndani nxënësit në çifte dhe identifikoni problemet më të mëdha. Ata ose mund t'i diskutojnë idetë e tyre ose t'i shënojnë ato, mirëpo duhet të jenë të gatshëm t'i ndajnë ato me grupin.

Diferencimi dhe alternativat

Për disa nxënës mund të jetë më mirë të nxiten që të mendojnë rreth problemeve në bashkësinë e tyre dhe në shtet, e pastaj të zgjerohen për të përfshirë problemet anekënd botës.

Gjatë punës me nxënësit më të rinj mund t'i pyetni për tre problemet kryesore dhe të kërkonin ta imagjinojnë veten në cilësinë e kryetarit të shtetit të tyre.

Ose anekënd klasës mund t'i ngjisni gjashtë fotografi (që i përfaqësojnë temat e qëllimeve). Pyetni nxënësit t'i shikojnë ato dhe të vendosin se cilin problem global e përfaqëson secila fotografi, Pastaj le të qëndrojnë pranë secilës fotografi që konsiderojnë se është më serioze. Kërkonin disa nxënës t'i shpjegojnë përzgjedhjet e tyre. Fotografi të përshtatshme mund të gjeni në www.globalgoals.org/worldslargestlesson

Pasi të dëgjojnë këta shpjegime lejoni nxënësit të mund të kalojnë te fotografia tjetër, nëse ndërkohë dëgjojnë ndonjë argument shumë bindës.

Si alternativë, përdorni shtojcën 1, e cila i numëron disa probleme dhe kërkon nga nxënësit, t'i theksojnë ato që mendojnë se janë më urgjente. Kjo mund të bëhet në nivel të bashkësisë / në nivel shtetëror dhe global, për të parë nëse ka dallime të perceptimeve të relevancës së niveleve në jetën e vetë nxënësve.

Aktiviteti mësimor

5 minuta

Sa probleme kanë identifikuar nxënësit. Krahasoni listat e tyre me Qëllimet globale, të ekspozuara para klasës ose të dhëna në materialet e shpërndara (shtojca 2 ose 3). Nënvizoni ato që përputhen.

Kjo mund të zgjerohet në diskutim në lidhje me atë se pse disa probleme janë përfshirë, ndërsa disa të tjera kanë ngelë të papërfshira. A ka qëllime, të cilat askush nuk i ka identifikuar? Nëse po, pse janë përfshirë ato?

Kuptimi i Qëllimeve globale

10 minuta

Nxënësit e shikojnë animaconin e Sër Ken Robinsonit në një ekran të madh, në ekran të kompjuterit, ose ulen në grupe, që ta shohin nga celulari në www.globalgoals.org/worldslargestlesson. Po ashtu në www.globalgoals.org/worldslargestlesson nxënësit mund të lexojnë librin komik, duke e lëvizur çdo kornizë në celular ose në tablet.

Aktiviteti mësimor

25 minuta

Pse këto probleme janë aq serioze? Nxënësit i vizitojnë gjashtë stacionet rreth klasës, me qëllim që t'i zgjerojnë njohuritë dhe të kuptuarit e tyre.

- Duhet të përcaktoni gjashtë stacione me informacione dhe resurse për t'iu mundësuar nxënësve të mësojnë më shumë për Qëllimet. Temat e sugjeruara për secilin stacion dhe Qëllimet globale që do të përfshihen janë dhënë në shtojcën 4.
- Në secilin stacion do të duhet të shënoni informacione shtesë, ku mund të përfshihet studim i rastit, tregime personale, fotografi, grafikë etj. Burime të përshtatshme mund të gjeni në www.globalgoals.org/worldslargestlesson
- Për të grumbulluar më shumë informacione në lidhje me qëllimet, nxënësit do ta vizitojnë në grupe secilin stacion. Ata kanë vetëm katër minuta në dispozicion në secilin stacion, andaj ju duhet t'u jepni sinjal se kur duhet të vazhdojnë më tej.
- Derisa janë në stacion secili grup i nxënësve duhet të shënojnë së paku një fakt, që i ka befasuar në secilin stacion. Ata njashtu mund të iniciojnë pyetje në secilin stacion, nëse dëshirojnë të mësojnë më shumë, si dhe mund të hulumtojnë në mësimet e mëtejme në shtëpi.

Diferencimi dhe alternativat

- Si alternativë në secilin stacion nxënësit mund të kenë një fletë me pyetje, të cilave dëshirojnë t'ua gjejnë përgjigje. Pyetjet do të varen nga resurset e zgjedha për secilën temë.
- Nëse janë të kufizuara koha hapësira dhe resurset, atëherë do të mund t'iu jepni nxënësve një fletë me përshkrim të shkurtër të disa nga problemet, të cilat synon t'i ndryshojë Qëllim. Nxënësit i lexojnë ato dhe vendosin se cili Qëllim do të ndihmojë për ta zgjidhur problemin përkatës. Ju mund ta mbështetni këtë duke përdore Qëllime miqësore për fëmijët të cilat mund t'i gjeni në www.globalgoals.org/worldslargestlesson

Aktiviteti mësimor

10 minuta

Nxënësit vendosin se cili qëllim është më i rëndësishëm, pse është i tillë, si ndërlidhet me qëllimet tjera dhe shkruajnë një paragraf, në të cilin e shpjegojnë përzgjedhjen e tyre.

Ata duhet t'iu referohen informacioneve, të cilat i kanë grumbulluar më herët nga situatat me gjashtë probleme.

Diferencimi dhe alternativat

Nëse koha është e kufizuar, atëherë mund të realizohet si detyrë shtëpie. Nxënësit mund t'i heqin ose klasifikojnë Qëllimet, duke e përdorë shtojcën 2 ose 3. Shtojca do t'iu ndihmojë atyre të përcaktohen për qëllimet më të rëndësishme. Ata mund njashtu të krijojnë një diagram, i cili paraqet lidhje ndërmjet qëllimeve dhe mënyrën sesi ata ndërlidhen mes vete, gjegjësisht varen nga njëri tjetri, p.sh. duke përdorë shigjeta ose duke inkurajuar mënyra tjera kreative për të paraqitur lidhje.

Aktiviteti mësimor

5 minuta

Në fund të mësimit, nxënësit e plotësojnë fjalinë “Qëllimet globale janë të rëndësishme për shkak se”. Ju mund të zgjidhni fjalinë “fituese”, mund ta kufizoni numrin e fjalëve, të cilët nxënësit kanë të drejtë t'i përdorin për të shkruar një titull gazete ose titull tuiteri [#largestlesson](https://twitter.com/theglobalgoals)

Projekte vijuese: Vizitoni www.dfcworld.com dhe shkëmbeni disa nga tregimet “Unë mund”, të cilat superheronjtë i kanë krijuar me fëmijët. Ndërmerrni projekt të grupit tuaj, për të bërë ndryshim në bashkësinë tuaj, duke përdorë modelin FIDS, ndërsa pastaj ndajeni suksesin tuaj me të tjerët në www.dfcworld.com.

Më shumë resurse në mësimdhënie për temat e ndërlidhura me Qëllimet globale

Për më shumë resurse për mësimdhënie nga ndihmat vullnetare dhe botuesit për një spektër të gjerë të çështjeve globale në drejtim të mbështetjes së qytetarisë globale, vizitoni ueb faqen për dimensione globale: www.globaldimension.org.uk

Për aktivitete mësimore dhe informacione në prapavijë për fëmijët që jetojnë në varfëri, vizitoni faqen e shkollës së UNICEF-it <http://teachunicef.org/>

Shtojca 1

Problemet me të cilat sot përballen njerëzit

(nëse është e nevojshme, përdoret me qëllim që të nxiten nxënësit)

- Varfëria
- Pabarazia mes shteteve
- Uria
- Shëndeti i ligë dhe sëmundja
- Uji i ndotur
- Mungesa e pajisjeve sanitare
- Arsimi i dobët – disa fëmijë nuk mund të shkojnë në shkollë
- Pagat e ulëta dhe mungesa e vendeve të punës
- Rritja e ulët ekonomike – shtetet nuk fitojnë sa duhet të holla për të paguar gjithçka që iu nevojitet njerëzve të tyre
- Pabarazia gjinore – burrat dhe gratë trajtohen ndryshe dhe nuk iu ofrohen mundësitë e njëjta
- Lufta, luftimet dhe paqëndrueshmëria
- Njerëzit nuk ndjehen të sigurt
- Dhuna ndërmjet njerëzve
- Korrupsioni dhe padrejtësia
- Mosrespektimi i të drejtave të njeriut
- Shtetet asnjëherë nuk punojnë së bashku dhe nuk pajtohen për asgjë
- Infrastrukturat e dobëta, teknologjia dhe komunikimi i dobët
- Fshatra dhe qytete të pasigurta
- Qytete të paqëndrueshme, të cilat mund të konsumojnë më shumë sesa mund të prodhojë bota
- Harxhohen tepër resurse dhe nuk riciklohen sa duhet
- Ndryshimet klimatike
- Ndotja e deteve dhe oqeanëve
- Dëmtimi i habitateve (mjedisëve jetësore)
- Ne kemi qasje të kufizuar në teknologji, celularë të shtrenjtë dhe kompjuterë
- Njerëzit nuk ndjejnë se janë të mbrojtur si duhet
- Rritja e popullsisë
- Obeziteti
- Racizmi
- Dobësimi i bashkësive

Shtojca 2

QËLLIMET GLOBALE
për zhvillim të qëndrueshëm

- 1 Jo varfëria**
- 2 Jo uria**
- 3 Shëndeti**
- 4 Arsimi cilësor**
- 5 Barazia gjinore**
- 6 Uji i pastër dhe kanalizim**
- 7 Energji e renovueshme**
- 8 Puna e mira dhe rritja ekonomike**
- 9 Inovacioni dhe infrastruktura**
- 10 Zvogëlimi i pabarazive**
- 11 Qytete dhe bashkësi të qëndrueshme**
- 12 Konsumimi i përgjegjshëm**
- 13 Mbrojtja e planetit**
- 14 Jeta nën ujë**
- 15 Jeta në tokë**
- 16 Paqja dhe drejtësia**
- 17 Partneritete qëllimet**

QËLLIMET GLOBALE

#TREGONISECILIT

Shtojca 3

Qëllimet globale – rezolucion i ulët versioni i shtypur

- 1 Jo varfëria**
- 2 Jo uria**
- 3 Shëndeti**
- 4 Arsimi cilësor**
- 5 Barazia gjinore**
- 6 Uji i pastër dhe kanalizim**
- 7 Energji e renovueshme**
- 8 Puna e mira dhe rritja ekonomike**
- 9 Inovacioni dhe infrastruktura**
- 10 Zvogëlimi i pabarazive**
- 11 Qytete dhe bashkësi të qëndrueshme**
- 12 Konsumimi i përgjegjshëm**
- 13 Mbrojtja e planetit**
- 14 Jeta nën ujë**
- 15 Jeta në tokë**
- 16 Paqja dhe drejtësia**
- 17 Partneritete qëllimet**

QËLLIMET GLOBALE

Shtojca 4

Emri i stacionit	Qëllimet e përfshira
Varfëria	1 Jo varfëri 10 Zvogëlim i pabarazive
Shëndeti dhe mirëqenia	2 Jo uri 3 Shëndet 6 Ujë i pastër dhe kanalizim
Arsimi, shkathtësitë dhe puna	4 Arsim cilësor 8 Punë të mira dhe rritje ekonomike
Bota e sigurt dhe e drejtë	5 Barazi gjinore 16 Paqe dhe drejtësi
Qëndrueshmëria	7 Energjia e renovueshme 9 Inovacion dhe infrastrukturë 11 Qytete dhe bashkësi të qëndrueshme 12 Konsumim i përgjegjshëm 17 Partneritete për qëllime
Mjedisi	13 Mbrojtja e planetit 14 Jeta nën ujë 15 Jeta në tokë